REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:068366
Datë: 08.09.2020
Numri i dokumentit: 01100349

P.nr.1893/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Fidan Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen penale kundër të akuzuarës E.Zh, nga Durrësit, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 të Kodit (nr.04/L-082) Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.2784-6/18 të datës 23.11.2018, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Shahadin Destani, të akuzuarës, me datë 08.09.2020, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

E.ZH, nga i ati A. dhe e ëma A. e lindur P., e lindur më datë ... në Durrës, Republika e Shqipërisë, me banim në rrugën " ..." lagjja ... , në Durrës, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës së Shqipërisë me nr. personal ... .

ËSHTË FAJTORE

Me datën 14.10.2018, rreth orës 21:55 në Pikën kufitare në ..., me qëllim të konsumimit substancave narkotike pa autorizim posedon me vete bimë narkotike me peshën prej 2.73 gram të llojit "Kanabis-Marihuanë", në atë mënyrë që pas kontrollit nga ana e policisë tek e dyshuara është gjetur një qese najloni, në të cilin kishte substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuan, përdorimi i së cilës është i ndaluar me Ligjin Nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë.

Me këtë, ka kryer veprën penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, paragrafi 2 të KPRK-së .

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 41, 49, 50, 51, 73, 74 dhe nenit 275 par.2 dhe 3 të KPRK-së, si dhe nenin me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarën e gjykon dhe atë:

2018:068367

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që vërteton - dënimin me gjobë në lartësi prej dyqind (200) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Në kuptim të nenit 275 par.3 të KPRK-së, substanca narkotike; një qese najloni me bimë narkotike të llojit kanabis me peshë neto 2.73 gram, **konfiskohet.**

Obligohet e akuzuara që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € dhe 30 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2784-6/18 të datës 23.11.2018, kundër të akuzuarës E.Zh nga Durrësi, Republika e Shqipërisë për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarës. E akuzuara pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Me datën 14.10.2018, rreth orës 21:55 në Pikën kufitare në ..., me qëllim të konsumimit substancave narkotike pa autorizim posedon me vete bimë narkotike me peshën prej 2.73 gram të llojit "Kanabis-Marihuanë", në atë mënyrë që pas kontrollit nga ana e policisë tek e dyshuara është gjetur një qese najloni, në të cilin kishte substancë të dyshuar narkotike të të llojit marihuan përdorimi i së cilës është i ndaluar me Ligjin Nr.02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarës për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast e akuzuara prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

2018:068367

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 të KPRK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethanë lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, e pa punë, është e gjendjes së dobët ekonomike, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së saj dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën e akuzuara është shpallur fajtor.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë konform nenit 275 par.3 të KPK-së lidhur me nenin 115 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:068366, 08.09.2020

G j y q t a r i

_____

Fidan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.